



GJAKOVË

PROJEKTI I PËRBASHKËT I BE/KE –

Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor
Komponenta e Zhvillimit Ekonomik Lokal
Pilot veprimet



JP - EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe

HISTORIKU

Komponenta e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZhEL) i Projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë* (PDKK) është frymëzuar dhe ndërlidhet ngushtë me Pilot Projektin për Zhvillim Lokal të Programit Rajonal (LDPP) të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për trashëgimi kulturore dhe natyrore në Evropën juglindore.

Përderisa Programi Rajonal ka fushëveprim më të gjerë në sferën e zhvillimit ekonomik, PDKK/ZhEL fokusohet në veçanti në njërin aspekt të programit rajonal: turizmi trashëgimor. Në këtë cilësi, PDKK/ZhEL synon që të krijojë kushtet për të ndihmuar kohezionin social dhe zhvillimin ekonomik përmes shfrytëzimit të potencialit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për rajonin e Kosovës Perëndimore.

Duke punuar me gjashtë komunat e Kosovës Perëndimore (Pejë, Gjakovë, Klinë, Deçan, Junik dhe Istog), projekti PDKK nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë, mirëmbajtjes dhe menaxhimit me qasje të integruar në procesin e zhvillimit

ekonomik lokal. Ky pilot projekt vendos strukturën e pranueshme, metodologjinë dhe shembujt se si, po qe se menaxhohet me efikasitet, trashëgimia mund të bëhet pasuri me dobi të madhe për komunitetet lokale si pjesë e procesit të zhvillimit dinamik social dhe ekonomik.

Në përgatitjen e Planit Rajonal të Trashëgimisë, projekti PDKK njih të gjitha lokalitetet dhe pasuritë e trashëgimisë në rajon, në bazë të informatave të siguruar nga autoritetet dhe institucionet qendrore dhe lokale. Megjithatë punon vetëm me ato pasuri trashëgimore që janë të qasshme dhe mund t'i prezantohen publikut të gjerë dhe vizitorëve për qëllime të turizmit trashëgimor.

Kjo fletushkë është përgatitur për akterët në komunën e Gjakovës për të shoqëruar planin rajonal të trashëgimisë dhe rekomandimet e tij, duke inkurajuar përfshirje aktive të komuniteteve dhe akterëve lokalë për zbatimin e veprimeve prioritare në komunë, në koordinim me pesë komunat tjera në rajon, si dhe me autoritetet qendrore.

Xhamia e Hadumit



Kulla e Koshit

*Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Muzeu etnografik

OBJEKTIVAT

Aktivitetet për zhvillimin ekonomik lokal dhe pilot veprimet fokusohen në:

- Vlerësimin e kapacitetit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit;
- Krijimin e një instrumenti për planifikimin strategjik për mbrojtje dhe revitalizim të trashëgimisë;
- Zhvillim të partneriteteve efektive në mes të akterëve të ndryshëm dhe inkurajimi i iniciativave publiko-private për trashëgimi;
- Krijimi i një zyreje rajonale për koordinim të bazuar në komunitet për menaxhimin e trashëgimisë.




METODOLOGJIA

Plani i Trashëgimisë është proces dinamik që jep kontekstin strategjik për veprimet e komunitetit me burimet ekzistuese për të siguruar përfitimet më të mëdha ndaj komunitetit lokal në rajon. Ai synon që të ndihmojë veprimet e përbashkëta në identifikimin e prioriteteve për shpërndarjen e fondeve në dispozicion për konservimin dhe promovimin e trashëgimisë, në koordinim me qeverinë qendrore, komunat dhe palët tjera me interes.

Me qëllim të sigurimit të angazhimit aktiv të akterëve, projekti PDKK ka përshtatur metodologjinë dhe rrjedhën e punës, ku komunitetet në vazhdimësi japin kontributin dhe pikëpamjet e tyre në politikëbërje, përdërisa në nivelin e komunitetit inkurajohet transferimi i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive.



Hani i Haragisë



KOMUNA E GJAKOVËS



Komuna e Gjakovës shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës, dhe ka popullsi prej rreth 150.000 banorë. Ajo përbëhet nga qyteti i Gjakovës, që ka rreth 90.000 banorë, dhe 84 fshatra me rreth 60,000 banorë.

Përveç shqiptarëve si komuniteti shumicë, komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian paraqet grupin më të madh pakicë, që numëron rreth 8,600 banorë.

Qyteti i vjetër i Gjakovës ishte një nga qendrat më të zhvilluara tregtare gjatë sundimit Osman në Ballkan. Trashëgimi e kësaj periudhe është Çarshia e Madhe që gjendet në qendër të qytetit të vjetër, me shumë dyqane të ruajtura dhe të restauruara, si dhe me objekte të banimit. Çarshia është ndërtuar rreth Xhamisë së Hadumit, e ndërtuar në vitin 1594-95, si donacion nga Hadum Sylejman Efendia (i njohur Hadum Aga). Ai njëkohësisht ka dhuruar fonde edhe për objektet tjera publike në qytet, përfshirë disa nga dyqanet e para në tregun e vjetër.

Në këtë Çarshi janë zhvilluar zeje të

ndryshme, përfshirë përpunuesit e metalit, lëkurës, drurit dhe zdrukthëtarisë, prodhimin e tekstilit, teneqepunues, shalëbërës (saraq) e kështu me radhë. Një nga ato zeje që ende ekzistojnë edhe sot, dhe njihet si markë (emër) potenciale në Gjakovë, është punimi i djepave. Rëndësia e kësaj zeje demonstroi imagjinatën artistike të zejtarit në përfaqësimin e besimeve tradicionale që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve të porsalindur.

Janë disa ura të vjetra që çojnë në Çarshinë e Madhe. Ato më karakteristike janë Ura e Tabakëve (shekulli 18) Ura e Terzive (shekulli 17), të dyjat mbi lumin Erenik, dhe ura e Taliqit, e ndërtuar në vitin 1816 mbi lumin Krena.

Trashëgimia natyrore e komunës së Gjakovës, siç është parku i Shkugëzës, liqeni i Radoniqit dhe gryka e Drinit të Bardhë, njihet nga popullsia lokale si shumë atraktive për vizitorët dhe për aktivitete në natyrë dhe për zhvillim të turizmit sportiv.

PËRFSHIRJA E KOMUNËS SË GJAKOVËS NË AKTIVITETET E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL

Në kontekst të projektit PDKK, janë kryer disa veprime me përfshirje aktive të akterëve lokal në komunën e Gjakovës.

- Hulumtimi i pasurisë së trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe kapaciteti i tyre për turizëm trashëgimor është kryer përmes anketave, intervistave dhe takimeve gjysmë të strukturuar me akterët, me pjesëmarrje të:

- Kompanisë për hulumtime UBO
- OJQ-së Arteza
- Vullnetarëve të komunitetit
- Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore në Gjakovë
- Komunës së Gjakovës

- Trajnimi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore

- Janë realizuar pilot veprimet në gjashtë komuna të Kosovës Perëndimore njëkohësisht. Këto pilot veprime përbëheshin nga tre komponentë që luajtën rol të rëndësishëm për angazhimin e komunitetit gjatë përgatitjes së Planit Rajonal për Trashëgimi.



"Sofra Gjakovare" - ngjarje kulturore



Kanioni i Drinit të Bardhë


PILOT VEPRIMET

Aktiviteti	Akterët lokal
A. IDENTIFIKIMI I PASURISË SË TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE	
I. Mbledhja e të dhënave për pasurinë e zgjedhur të trashëgimisë kulturore dhe natyrore	
<i>Mbledhja e të dhënave për pasurinë e trashëgimisë së paluajtshme kulturore</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Teqja e Shesh Eminit (shekulli 17) • Sahat kulla (1912, e rinovuar në vitin 2009) • Xhamia e Hadumit (1594-95) • Hani i Haraqisë (shekulli 19) • Muzeu etnografik (1810) • Kulla e Koshit (1870) • Ura e Terzive (shekulli 17) • Ura e Tabakëve (shekulli 18) • Ura e Taliqit (1816) 	<ul style="list-style-type: none"> - Qendra rajonale për trashëgimi kulturore në Gjakovë - OJQ Arteza - Ekipi i projektit të PDKK
<i>Mbledhja e të dhënave për pasurinë e trashëgimisë kulturore jomateriale</i>	
Djeppunuesit	- OJQ Arteza
<i>Mbledhja e të dhënave për pasurinë e trashëgimisë natyrore</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Gryka e Drinit të Bardhë • Liqeni i Radoniqit • Parku i Shkugëzës 	<ul style="list-style-type: none"> - OJQ Arteza - Valmira Gashi (MMPH)
II. Materialet promovuese	
<ul style="list-style-type: none"> • Dizajnimi i Hartës së Trashëgimisë së Gjakovës • Dizajnimi dhe prodhimi i tabelave informative për secilin nga pasuritë e përzgjedhura natyrore dhe kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> - OJQ Arteza - Komuna e Gjakovës
B. PRAKTIKA E TRASHËGIMISË JOMATERIALE	
I. Identifikimi	
<ul style="list-style-type: none"> • Djeppunues • "Sofra Gjakovare"- Muzikë tradicionale qytetare 	- OJQ Arteza
II. Trajnimi	
<ul style="list-style-type: none"> • Trajnim për punimin tradicional të djepave (5 nxënës) • Trajnim për punimin e cigarllëkëve (5 nxënës) 	<ul style="list-style-type: none"> Nga z. Ruzhdi Qarri, djeppunues Nga z. Sefedin Koburja, punues i cigarllëkëve
III. Organizimi i ngjarjeve rreth trashëgimisë kulturore jomateriale	
<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i Muzikës qytetare tradicionale "Sofra Gjakovare" (8 korrik 2011), e mbajtur në Çarshinë e Jupave në Gjakovë • "Sofra Gjakovare" - film dokumentar 	- OJQ Arteza
C. NGJARJET E PËRBASHKËTA RAJONALE PËR TURIZMIN KULTUROR	
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në Festivalin Rajonal Vjeshtor të mbajtur në Gjakovë (25 nëntor 2011) dhe në Pejë (26 nëntor 2011). Komuna e Gjakovës është përfaqësuar me zeje, prodhues lokalë të ushqimeve tradicionale dhe interpretues të muzikës tradicionale. 	<ul style="list-style-type: none"> - OJQ Arteza Gjakovë - Zejtarët, prodhuesit dhe interpretuesit e Pejës dhe Gjakovës - Ekipi i projektit të PDKK
<ul style="list-style-type: none"> • "Ditët artizanale", që u mbajtën në Gjakovë (29 nëntor - 10 dhjetor 2010) 12 zejtarë nga rajoni perëndimor u mblodhën në Çarshinë e Madhe në Gjakovë për të ushtruar dhe demonstruar shkathësitë e tyre për 12 ditë. 	<ul style="list-style-type: none"> - OJQ Arteza - Zejtarët nga rajoni perëndimor i Kosovës - Ekipi i projektit të PDKK

Aktiviteti	Akterët lokalë
Arsimi dhe ngritja e vetëdijes	
Dizajnimi i kursit për trashëgimi dhe diversitet për shkollat fillore	Nxënësit, prindërit dhe mësuesit nga shkolla fillore Zekeria Rexha, komuna e Gjakovës
Turnetë HAJDE - vizita të lokaliteteve	Nxënësit nga shkolla fillore Zekeria Rexha, komuna e Gjakovës Grupet nga komunitetet pakicë; Personat me nevoja të veçanta.
Trajnimi i mësuesve për trashëgimi dhe diversitet	2 mësues nga shkolla fillore Zekeria Rexha, komuna e Gjakovës
Zhvillimi i Kapacitetit Institucional	
Hartimi i udhëzuesve për zbatim të ligjit të Kosovës për trashëgimi kulturore	Drejtori i Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore në Gjakovë
Vizitat studimore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipëri, Mal të Zi, Belgjikë, Zvicër, Irlandë, Turqi, Venedik, Slloveni, Irlandë	Përfaqësuesit e GPK nga Gjakova, Përfaqësuesit e Qendrës Rajonale Për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, OJQ Arteza.
"Lidhjet: Konferenca rajonale për trashëgiminë kulturore jomateriale", Mars 2012	Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, OJQ Arteza



Shkëlqëza



Ura e Taliqit

VEPRIMET PRIORITYRE TË REKOMANDUARA PËR KOMUNËN E GJAKOVËS BRENDRA PLANIT RAJONAL PËR TRASHËGIMI 2012-2015

Më poshtë është dhënë lista e rekomandimeve për veprime në Gjakovë që janë në vijë me Planin Rajonal të Trashëgimisë për Kosovën Perëndimore 2012-2015 dhe me komunat e tjera në rajon.

Të ngritet vetëdija dhe të promovohet vlerësimi i trashëgimisë në Kosovën Perëndimore

- Pjesëmarrja në festivalet vjetore rajonale për të ngritur vetëdijen në mesin e publikut për aktivitetet, siç është muzika qytetare tradicionale "Sofra Gjakovare"
- Përkrahja e aktiviteteve vetëdijesuese nëpër shkollat e komunës
- Vazhdimi i organizimit të Sofrës Gjakovare, me materialet promovuese që publikohen me kohë
- Shfrytëzimi i logos rajonale për të krijuar emrin
- Mbledhja e rregullt e mbeturinave dhe ngritja e vetëdijes rreth rëndësisë së mjedisit të pastër

Të ndërmerren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Perëndimore

- Hulumtimi dhe identifikimi i praktikave unike të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Gjakovë me qëllim të dokumentimit të tyre sipas udhëzuesve
- Vendosja në hartë e pasurive të trashëgimisë kulturore të palëvizshme, të lëvizshme, jomateriale dhe natyrore, me informata përkatëse, dhe përditësimi i rregullt i tyre me autoritetet qendrore
- Përgatitja e listës me objektet e rrezikuara të komunës

Të zhvilloj dhe inkurajoj përmes vlerësimit, hartimin e dhe planifikimin e projektit të integruar përmes planit efektiv për menaxhim të trashëgimisë në Kosovën Perëndimore

- Identifikoj standarde të nevojshme për ofrimin e shërbimeve turistike dhe ofrimin e trajnimeve për ofruesit lokal të shërbimit
- Përgatitja e hartës së qartë dhe të përditësuar të turizmit

trashëgimor, me të gjitha lokalitetet të cilat janë të gatshme për vizitorët

- Të jep kontribut për raportin rajonal vjetor për 'Gjendjen e Trashëgimisë' në Kosovën Perëndimore
- Të siguroj shenjëzim adekuat për lokalitetet që janë të gatshme për turizëm
- Të testoj produktet kulturore dhe stilet e marketingut në zonat përkatëse të punës në rajon

Të zhvillohen dhe koordinohen praktikatat adekuate menaxhuese për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Perëndimore

- Organizimi i zhvillimit të kapacitetit për ngritje të aftësive për menaxhim të trashëgimisë, përfshirë ciceronët lokal
- Pjesëmarrja në takimet/forumet e rregullta për të ndarë me të tjerët zhvillimet dhe për t'u njoftuar rreth programit rajonal
- Dërgimi i broshurave dhe materialeve promocionale të prodhuara në komunë tek Zyra Rajonale Koordinuese

Të zhvillohen nismat e duhura lokale dhe të qëndrueshme të trashëgimisë në Kosovën Perëndimore

- Identifikimi i strukturës së kullave në komunë për pjesëmarrje në iniciativën e shtigjeve kulturore
- Investimi në një produkt kulturor në bazë të praktikave lokale të trashëgimisë kulturore (prodhimi i djepave dhe cigarllëkve), dhe identifikimi i një produkti tjetër
- Përkrahja për nismat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), përfshirë Bed & Breakfast
- Të bëhet Gjakova destinacion turistik për praktika tradicionale zejtare dhe industri kreative në rajon në pajtim me revitalizimin e Qarshisë së Madhe.

PARTNERËT DHE AKTERËT E PËRFSHIRË

Partnerët kryesorë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Komuna e Gjakovës

OJQ-të: Arteza dhe Besimi për Transformim Rural

Anëtarët e Grupit Rajonal Punues

Avdyl Hoxha, Drejtor i Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore - Pejë • Osman Gojani,

Drejtor i Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore - Gjakovë • Shpresa Gjonbalaj,

Drejtoreshë e Drejtorisë për kulturë - komuna e Pejës • Engjëll Berisha, Drejtor i bibliotekës - komuna e Gjakovës • Musa Kaliqani,

Udhëheqës i Drejtorisë për ekonomi - komuna e Istogut • Hajdin Morina, Zyrtar për arsim - komuna e Klinës • Nimon Tofaj, Nënkyetar

i komunës së Junikut • Shkëlzen Shehu, Drejtorja për urbanizëm - komuna e Deçanit

• Kujtim Rrahmani, OJQ Arteza - Gjakovë

• Shasimete Selimaj, OJQ 7 Shtatori - Pejë • Rexhep Maksutaj, OJQ Agimi - Deçan

Anëtarët e Grupit Punues Komunal (Gjakovë)

Osman Gojani, Drejtor i Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore - Gjakovë • Xhemile Boshnjaku, Drejtorja për arsim - komuna

e Gjakovës • Engjëll Berisha, Drejtorja për kulturë - komuna e Gjakovës • Masar Rizvanolli, Shoqata e intelektualëve Jakova - Gjakovë • Ali Haraqija, Zejtar - Gjakovë • Kujtim Rrahmani, OJQ Arteza - Gjakovë • Florinda Rudi, OJQ Besimi për transformim rural - Gjakovë • Shkelqim Jupa, Përfaqësues i biznesit lokal - Gjakovë • Mahmut Lila, Mjek - Gjakovë • Elida Bejtullahu, Drejtorja për urbanizëm - Gjakovë • Ali Shehu, Përfaqësues i sektorit të turizmit - Gjakovë • Alban Meka, Piktur - Gjakovë • Shkelzen Saraqini, Arkeolog - Muzeu Etnografik i Gjakovës

Vullnetarët

Ardiana Rrahmani OJQ Arteza

Ekspertët, përfaqësuesit e institucioneve/ autoriteteve dhe kompanitë private të

përfshira:

Terry O'Regan, Ekspert nga Këshilli i Evropës (Irlandë) • Liam Scott, Këshilli i trashëgimisë së Irlandës • Bob Charmburry, Konsulent i pavarur për zhvillimin ekonomik • Zekë Çeku, Konsulent i pavarur për zhvillimin e

turizmit • Burbuqe Deva, Përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit • Valmira Gashi, Eksperte nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor • Arsim Mulhaxha, Përfaqësues nga Qendra rajonale për trashëgimi kulturore në Pejë • Vergina Dyla, Përfaqësues nga Qendra rajonale për trashëgimi kulturore në Gjakovë • Jeton Aliu, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Departamenti i turizmit • UBO Consulting Company

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë'. Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

KONTAKTET:

Për hollësi shtesë dhe mundësi për bashkëpunim, kontaktoni:

Koordinatorët e zyrës për PMT:

Blertha Harxhi-Begolli,
blertha.harxhi@phm-west.org

Nermin Kastrati,
nermin.kastrati@phm-west.org

Tel: +381 (0)39. 421. 651
Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 85,
30000 Pejë

Projekti i PDKK-së
Zyra e Këshillit të Evropës
në Prishtinë
Rruga Bedri Pejani nr. 3 -
10000 Prishtinë
Tel: +381 (0)38 243 751



JP - EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe